



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 362/2024

Datë: 15 / 10 / 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Metije Ademi, Drejtore e Departamentit për Lirim me Kusht në Shërbimin Sprovues të Kosovës, caktohet Ushtrues Detyre e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ushtruesja e detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi është gjashtë (6) muaj dhe fillon nga datë 15.10.2024.
4. Obligohet Shërbimi Sprovues i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Metije Ademi;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Shërbimit Sprovues të Kosovës, dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*